



INFORMATA RRETH PROJEKTIT HULUMTUES - SHKENCOR
“ZHVILLIMET KULTURORE – HISTORIKE TE SHQIPTARËT E MAQEDONISË
GJATË SHEKULLIT XIX-XX”

Titulli i projektit	-“Zhvillimet kulturore – historike te shqiptarët e Maqedonisë gjatë shekullit XIX-XX”
Institucioni publik shkencor mbajtës i projektit	IPSH Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup
Hulumtuesi kryesor	Prof. dr. Skender Asani , këshilltar shkencor
Ekipi hulumtues:	Prof. dr. Sevdail Demiri, Doc. dr. Besnik Rameti Asst. Emin Azemi, Asst. Sali Islami
Zona e kërkimit shkencor, fusha dhe zona e projektit	Shkenca humane, histori, kulturologji
Kohëzgjatja e projektit	2021 -2023
Përdoruesit e rezultateve	IPSH Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, institutet tjera dhe universitetet e interesuara
Mbështetur nga	Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut



REZYMEJA

Projekti “Zhvillimet kulturore – historike te shqiptarët e Maqedonisë gjatë shekullit XIX-XX”, paraqet një hulumtim kompleks shkencor, që ka për qëllim të studiojë të kaluarën e fundit dyshekullore të shqiptarëve të Maqedonisë. Konkretisht, hulumtimi fokusohet më tepër te zhvillimet kulturore e historike te shqiptarët e Maqedonisë gjatë shekullit XIX-XX, të cilat kanë qenë mjaft të vrullshme në atë periudhë.

Periodha c caktuar përkon me zhvillimet të shpejta dhe ndryshimet në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, si rezultat i ndryshimeve që ndodhin edhe në nivel botëror nga përsheptimi i procesit të industrializimit dhe zhvillimit tekniko-teknologjik.

Shqiptarët gjatë kësaj periudhe jetonin brenda kornizave të Perandorisë Osmane, dhe gjatë kësaj kohe merr formë kombi shqiptar, si rezultat i përpjekjeve të rilindësve tanë që jetonin kryesisht nëpër vendet e huaja në mërgim. Rilindja Kombëtare Shqiptare luan një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e shqiptarëve kombëtarisht, duke dhënë një kontribut të madh në ngritjen e tyre arsimore e kulturore.

Shqiptarët që jetojnë sot brenda kufijve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhanë një kontribut të çmueshëm në të gjitha fazat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Njëra nga vlerat më kulmore të shqiptarëve nga vendi ynë, është Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir (1908), kur për herë të parë, pas një periudhe të gjatë pesëshekullore nën sundimin osman, shqiptarët u bënë bashkë për të promovuar një alfabet të përbashkët me shkronja latine, i cili ishte baza për vulosjen e orientimit properëndimor të shqiptarëve.

Kontributi i këtij projekti në thellimin dhe zgjerimin e njohurive shkencore, konsiston në mbledhjen, grumbullimin dhe studimin e dokumenteve dhe fakteve të reja rreth ngjarjeve të shumta kulturore e historike të shqiptarëve të Maqedonisë gjatë shekujve XIX dhe XX.

Originaliteti i qëllimeve të projektit qëndron në faktin se shumica e dokumenteve të prezantuara për herë të parë para publikut, janë një freski e rëndësishme për shkencën e historisë.

Subjekti i hulumtimit shtrihet në gjithë hapësirën shqiptare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke filluar nga Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Manastiri, Dibra, Kërçova, Ohri e Struga. Është hulumtuar nëpër arkivat qendrore e lokale, nëpër bibliotekat qendrore e lokale të këtyre qyteteve, si dhe janë gjurmuar gojëdhënat relevante që ende mund të përdoren si burim i rëndësishëm informacioni historik. Po ashtu janë hulumtuar edhe arkivat shtetërore të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Turqisë, Republikës së Italisë, dhe veçanërisht Arkivi i Republikës së Kroacisë, ku u gjend një thesar i jashtëzakonshëm dhe i pa hulumtuar fare për historinë e shqiptarëve të Maqedonisë gjatë shekujve XIX dhe XX.

I gjithë hulumtimi është botuar në një studim të veçantë në rreth 500 faqe, me pjesën studimore dhe atë dokumentare.



QËLLIMET

Duke e pasur parasysh faktin se deri më tani nuk ishte ndonjë hulumtim serioz gjithëpërfshirës e në mënyrë institucionale për temën e lartpërmendur, nga ana e studiuesve shqiptarë, ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që të thellohen studimet në këtë fushë dhe të nxirret një kontribut konkret për një të kaluar dyshekullore të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte që ai më tutje të jetë një bazë solide për shkrimin e historisë së përgjithshme të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, pikërisht nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, si institucion relevant që është i përkushtuar dhe i takon të merret profesionalisht me këtë problematikë shkencore.

Ndër qëllimet tjera veçojmë:

-Thellimi i studimeve shqiptare për periudhën dyshekullore, kur në trojet e sotme të Republikës së Maqedonisë së Veriut u zhvilluan ngjarje të mëdha kulturore e historike në rang kombëtar;

-Nxjerrja e kontributeve konkrete, publikimi i librave studimore e dokumentare, të cilat paraqesin bazë solide për shkrimin e historisë së përgjithshme të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut;

-Formimi i një platforme të etabluar shkencore, e cila mund të merret si bazë gjatë përpilimit të teksteve të reja shkollore të lëndës së historisë dhe shoqërisë, të cilat fatkeqësisht vazhdojnë të botohen me lëshime të theksuara;

-Origjinaliteti i dokumenteve shumica e të cilave për herë të parë prezantohen para auditorit shkencor, të jenë një freski e rëndësishme për shkencën e historisë, dhe jo vetëm, për të zbuluar aspekte të reja tematike;

-Vënia e themeleve të shëndosha të shkencës historiografike ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, kur janë në pyetje zhvillimet kulturore – historike të shqiptarët e këtyre trevave gjatë shek. XIX-XX;

-Studiuesit e huaj (joshqipfolës) të kenë edhe një mundësi të re për njohjen e realitetit objektiv të shqiptarët e kësaj treve gjatë kësaj periudhë komplekse kohore që kapë shekujt XIX-XX, etj.



REZULTATET

Disa nga rezultatet e zhvillimit të projektit hulumtues – shkencor: “Zhvillimet kulturore – historike te shqiptarët e Maqedonisë gjatë shekullit XIX-XX”, janë:

-Studimi i parë serioz dhe gjithëpërfshirës i realizuar e në mënyrë institucionale nga ana e studiuesve shqiptarë të ITShKSh – Shkup për historinë dhe kulturën shqiptare në Maqedoninë e Veriut për periudhën e shekujve XIX-XX;

-Hulumtimi i arkivave të rëndësishme shtetërore rajonale dhe të huaja lidhur me temën e zhvillimeve kulturore dhe historike të shqiptarëve të Maqedonisë gjatë shekujve XIX-XX;

-Pajisja e ITShKSh – Shkup me dokumente të rëndësishme historike, të cilat do t’u shërbejnë studiuesve edhe në të ardhmen për tema të tjera hulumtuese dhe komparative;

-Krahasimi i arritjeve shkencore të deritanishme të kësaj fushe, pra burimet e botuara vendore (shqipe dhe maqedonase) dhe ato ndërkombëtare;

-Analize e thuktë krahasimtare për verifikimin e të dhënave shkencore, që janë shumë të rëndësishme për shkencën historike dhe studimet albanologjike në përgjithësi;

-Publikimi i studimit dhe hulumtimit në një libër të veçantë të ITShKSh – Shkup, me 502 faqe të formatit B5, me temën qendrore të projektit;

-Promovimi i projektit dhe më tej i librit në mënyrë të veçantë në Shkup, dhe më pas në Prishtinë, Tiranë dhe qendra tjera të rëndësishme rajonale dhe botërore;

-Publikimi i rezultateve shkencore nga ky projekt, në të ardhmen edhe në gjuhë të huaja, do të thotë se burimi i informacionit është shumë i saktë dhe i mirëseardhur për studiuesit e huaj, pikërisht për faktin se bëhet në një teren autokton, për të cilin shqiptarët po shkruajnë mbase për herë të parë në një mënyrë të tillë serioze shkencore;

-Në kontekst të njohjes ndërkombëtare të zhvillimeve kulturore – historike të shqiptarëve të Maqedonisë gjatë shekullit XIX-XX, studiuesit e huaj që janë mjaft të interesuar edhe për të kaluarën e popujve të vegjël ballkanikë, siç jemi ne shqiptarët, do të kenë edhe një derë të hapur për thellimin e studimeve të tyre për këtë periudhë kohore;

-Gjurmë e rëndësishme për historinë dhe albanologjinë shkencore në përgjithësi;

-Pajisja e ITShKSh – Shkup me dokumente, literaturë dhe pajisje logjistike (inventarë e të ngjashme), për nevojat e hulumtuesve shkencorë, etj.

Shkup, 30.11.2023